



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr.206, datë 20.05.2021

PËR
VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT NGA KANDIDATI Z. {...}
TË KATËR KRITEREVE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË
GJYKATËN E POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE
KRIMIN E ORGANIZUAR, PËR POZICIONIN E LIRË TË SHPALLUR ME
VENDIMIN NR. 127, DATË 01.04.2021, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR,
VIJIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT PËR KRITERET E TJERA LIGJORE
TË KANDIDIMIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 20.05.2021, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e katër prej kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të kandidatit z. {...}”, përgatitur nga relatori z. Alban Toro, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 127, datë 01.04.2021, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale” dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit,

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr.127, datë 01.04.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

“1. Rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë...”

3. Afati i kandidimit është dy javë nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor... ”.

2. Afati i kandidimit në këtë procedurë ngritjeje në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, është përcaktuar “*deri më datë 16.04.2021*”.

3. Brenda afatit të kandidimit, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin si më sipër, ka kandiduar gjyqtari z. {...} (më poshtë referuar si kandidati), gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, aktualisht i transferuar përkohësisht pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

4. Me Vendimin nr. 179, datë 29.4.2021, Këshilli ka vendosur:

“1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet ... nr. 127 dhe ..., datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

...

3. Për kandidatin z. {...}, i cili ka kandiduar më parë për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Vlorë, procedura e verifikimit sa i përket pasurisë dhe figurës që është në proces e sipër për këtë kandidim, është e vlefshme edhe për kandidimin e tij për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 127, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

5. Më herët, z. {...}, ka kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Vlorë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 545, datë 05.11.2020. Për këtë kandidim, z. {...} është në proces verifikimi, arsye për të cilën në pikën 3, të Vendimit të tij nr. 179, datë 29.04.2021, Këshilli vendosi që procedura e verifikimit sa i përket pasurisë dhe figurës që është në proces e sipër, është e vlefshme edhe për kandidimin e tij për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

6. Lidhur me kandidimin për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, më datë 29.04.2021, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), në rrugë elektronike, kandidati u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 127, datë 01.04.2021, si dhe për faktin që kjo procedurë do të ndiqet nga i njëjti relator.

7. Po më datë 29.04.2021, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidatit iu dërgua Autorizimi “Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, si dhe Deklarata “Për dhënien e pëlqimit për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale”, sipas pikës 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.

8. Brenda afatit pesëditor, kandidati depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

9. Sipas pikës 9, të Vendimit të Këshillit nr.127, datë 01.04.2021, është përcaktuar se: *“Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “b”, “ç” dhe “d” të pikës 5 të këtij vendimi, fillon procesi i vlerësimit etik dhe profesional:...”*. Ndërkohë, në pikën 5, shkronja “a”, të Vendimit të Këshillit nr.127, datë 01.04.2021, përcaktohet se: *“Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar përcaktohen ..., si më poshtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar në fushën e drejtësisë kriminale, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”. Nga ana tjetër, në shkronjat “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, përcaktohet se: “b) Kandidati duhet të japë pëlqimin (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”; c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi; ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.*

10. Në respektim të vendimit si më lart të Këshillit, sa i përket plotësimit të katër kriterëve formale të sipërpërmendura të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me qëllim realizimin paralelisht edhe të procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, pra në funksion të përmbylljes sa më parë të procedurave të kandidimit, për kandidatin z. {...}, u administrua informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili është përcjell në rastin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Vlorë.

11. Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale” dhe pikërisht sa i përket “përvojës specifike profesionale” të kandidatit në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë ku ai ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës penale/drejtësisë kriminale, referuar gjykatave ku kandidati ka ushtruar funksionin e gjyqtarit, konkretisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor

Kavajë, u administrua informacioni i ardhur nga të trija këto gjykata në kuadër të procesit të verifikimit të kushteve të kandidimit të z. {...} për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Vlorë. Në këtë rast u vlerësua i panevojshëm rikërkimi i informacionit nga këto gjykata, meqenëse informacioni i dërguar nga ato sjell të dhëna pikërisht për përvojën e kandidatit në fushën e të drejtës penale.

12. Për kriterin e “mospasjes masë disiplinore në fuqi” u kryen disa veprime verifikuese, sikurse do të përshkruhen më poshtë, në funksion të verifikimit të ekzistencës së ndonjë të dhëne të ndryshme nga sa më parë, kjo për shkak se kjo rrethanë është potencialisht e ndryshueshme qoftë edhe në një kohë të shkurtër.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PARAPRAK PËR KATËR KRITERET E KANDIDIMIT

13. Për kandidatin z. {...} u verifikua kriteri i “përvojës profesionale minimale”.

13.1 “Përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, që gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 127, datë 01.04.2021, është parashikuar si kriter kandidimi, në nenin 47, pika 2, shkronja “a”, të Ligjit për Statusin. Sipas kësaj dispozite, ky kriter kandidimi përbëhet në vetvete nga dy të tillë, ai për “përvojën e përgjithshme profesionale minimale” dhe ai për “përvojën specifike profesionale minimale”. Konkretisht në këtë dispozitë të ligjit përcaktohet se: *“Për pozicionin gjyqtar në gjykatën e posaçme të shkallës së parë për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar në fushën e drejtësisë kriminale ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”.*

13.2 Për verifikimin e kandidatit në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, u mbajt parasysh se kandidati, krahas përvojës së përgjithshme profesionale minimale, duhet të plotësojë edhe përvojën specifike profesionale minimale, pra jo më pak se pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, konkretisht në fushën e të drejtës penale.

13.3 Kriteri i “përvojës profesionale minimale” për kandidatin është verifikuar më parë nga Këshilli në kuadër të kandidimit të tij të mëparshëm (datë 21.01.2021) për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Vlorë, referuar për këtë Vendimit të tij nr. 15, datë 21.01.2021, në të cilin është arritur në përfundimet se:

“17. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjell nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati z. {...}, ka filluar detyrën me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.8353 datë 21.10.2020, ku është emëruar për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në vijim, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.9242 datë 25.09.2015, ai është emëruar

përfundimisht gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë . Më pas, me Vendim nr. 47 datë 13.06.2018 të Këshillit të Lartë Drejtësisë, është transferuar për një vit për të gjykuar në Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë. Më pas i është përsëritur transferimi me vendimet nr.96 datë 21.06.2019 dhe nr.205 datë 22.06.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë ku vazhdon dhe aktualisht.

18. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Vlorë për pozicionin e lirë (në fushën e të drejtës penale) të shpallur me Vendim të Këshillit nr.545, datë 05.11.2020, ka mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtar në gjykatën e shkallës së parë dhe si i transferuar përkohësisht, duke plotësuar kështu kriterin “përvojës profesionale minimale”.

19. Në lidhje me përvojën specifike profesionale, në kërkesën për shprehje interesi, kandidati ka deklaruar se ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në çështjet civile, familjare dhe penale pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Korçë dhe Kavajë.

20. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjell nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se: {...} fillim e detyrës e kam me dekret nr. 8385 date 21.10.2013 ku është emëruar për të kryer stazhin profesional pranë kësaj gjykate ku ka gjykuar çështje me natyrë të përgjithshme, si çështje civile/ familjare si dhe çështje penale.

20.1 Ndërsa sipas informacionit dhe dokumentacionit në formë tabelore të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për periudhën nga 21.10.2013 -31.12.2014 ka gjykuar përkatësisht 139 çështje gjyqësore, ku nga këto:

- 8 çështje janë në fushën penale,
- 23 çështje të përgjithshme,
- 8 çështje familjare,
- 16 masa sigurimi,
- 84 çështje civile.

- Me urdhrin “Mbi pjesëmarrjen në gjykimin e masave të sigurimit të kandidateve për magjistratë”, nr. 112/1 datë 21.11.2013 kandidati është caktuar të jetë pjesë e masave të sigurimit për muajin nëntor.
- Me urdhrin “Mbi pjesëmarrjen në shortin civil e kandidateve magjistratë”, nr. 128 datë 18.12.2013 kandidati është caktuar të gjykojë në seksionin civil familjare
- Me urdhrin “Mbi pjesëmarrjen në shortin civil e kandidateve magjistratë”, nr. 128/1 datë 19.12.2013 kandidati është caktuar të gjykojë në seksionin civil të përgjithshme.
- Me urdhrin “Mbi pjesëmarrjen në shortin penal të kandidateve magjistratë”, nr. 149 datë 03.02.2014 kandidati është caktuar të gjykojë në seksionin penal.
- Me urdhrin “Mbi pjesëmarrjen në gjykimin e masave të sigurimit të kandidateve për magjistratë”, nr. 187 datë 16.05.2014 kandidati është caktuar të jetë pjesë e masave të sigurimit për muajin maj.

- Me urdhrin “Mbi pjesëmarrjen në gjykimin e masave të sigurimit të kandidatëve për magistratë”, nr. 193 datë 20.06.2014 kandidati është caktuar të jetë pjesë e masave të sigurimit për muajin qershor.

21. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, për periudhën shtator 2015 deri më qershor 2018, rezulton se ai ka qenë i caktuar si gjyqtar në dhomën civile/seksioni civil i përgjithshme dhe tregtar. Gjithashtu sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë janë vënë në dispozicion urdhrat e Kryetarit të Gjykatës si dhe për këtë periudhë kohore kandidati z. {...} ka gjykuar (sipas radhës së gatisshmërisë) çështje penale me objekt caktim mase sigurie, çështje të cilat janë shqyrtuar nga gjyqtarët e dhomës civile.

- Me urdhrin “Për një ndryshim në urdhrin e brendshëm nr. 11 datë 12.01.2015, ndryshuar me urdhrin nr.174 datë 03.08.2015 “Mbi shpërndarjen e gjyqtareve në dhoma seksione dhe trupa gjykues”, nr. 192 datë 07.10.2015 kandidati është caktuar në seksionin civil të përgjithshme dhe tregtar.
- Me urdhrin “Mbi shpërndarjen e gjyqtareve në dhoma seksione dhe trupa gjykues”, nr. 212 datë 05.10.2016 kandidati është caktuar në seksionin civil të përgjithshme dhe tregtar.

21.1 Nga dokumentacioni i administruar deri më tani, referuar kriterit të “përvojës profesionale minimale”, sipas shkronjës “a”, pika 5, të nenit 47, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli me shkresën nr. 5871/14 prot., më datë 23.12.2020 i ‘u drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë me objekt kërkesë “rikërkim informacioni” dhe identifikimin në mënyrë të përmbledhur të dhënave për çështjet penale të gjykuara nga ky gjyqtar për periudhën kohore 25.09.2015- 13.06.2018. Kjo e fundit (në rrugë elektronike dhe postare) me shkresë nr. 319 prot., datë 28.12.2020 ka përcjell informacionin e kërkuar në formë tabelore të ndarë me periudha kohore në lidhje me çështjet penale të gjykuara nga gjyqtarët e seksionit penal, në veçanti për kandidatin z. {...}. Sipas Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për periudhën 25.09.2015 deri më 05.10.2016 z. {...} ka gjykuar 75 çështje penale, nga të cilat 6 penale themeli, 15 kërkesa penale dhe 54 masa sigurimi. Për periudhën 06.10.2016 deri më 13.06.2018 z. {...} ka gjykuar 127 çështje penale nga të cilat 18 penale themeli, 30 kërkesa penale, 78 masa sigurimi dhe 1 seancë paraprake.

22. Sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, për periudhën qershor 2018 e në vijim gjyqtari {...} ka një përvojë profesionale specifike si gjyqtar në fushën e të drejtës penale dhe civile, duke gjykuar një numër të madh çështjesh civile dhe penale, Nga periudha 2018 e deri më sot z. {...} ka gjykuar rreth 100 çështje penale themeli dhe rreth 905 kërkesa penale. Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë nuk është nxjerr urdhrë për ndarje në dhoma/ seksione të gjyqtareve për shkak të organikës së gjykatës, e cila nuk e lejon një ndarje të tillë.

23. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Vlorë, për pozicionin e lirë (në fushën e të drejtës penale) të shpallur me Vendim të Këshillit nr.545, datë 05.11.2020, ka pesë vite përvojë

profesionale në fushën e të drejtës penale, duke plotësuar kështu kriterin e “përvojës specifike profesionale minimale”.

13.4 Nga sa ka rezultuar, duke mbajtur në konsideratë se faktin se edhe pas kandidimit të mëparshëm për ngritjen në detyrë, kandidati z. {...} ka vijuar ushtrimin e funksionit në të njëjtën gjykatë (Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë), Këshilli arrin në përfundimin se ai, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (16.04.2021), ka mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtar në gjykatën e shkallës së parë, nga të cilat mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës penale.

14. Për kandidatin z. {...} u verifikua kriteri i “Dhënies së pëlqimit (ai/ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

14.1 “Dhënia e pëlqimit (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” si kriter për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, që gjen reflektim në shkronjën “b”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 127, datë 01.04.2021, është parashikuar në nenin 47, pika 3, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “Për të gjitha pozicionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, magjistrati duhet të përmbushë edhe kriteret e tjera dhe kushtet e sigurisë, të parashikuara në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, i cili në fakt është një dispozitë referuese e cila referon konkretisht në nenin 48, pika 1 dhe 2 të Ligjit nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, që përcakton se: “1. Përpara emërimit, kandidatët për gjyqtarë dhe pozicione të tjera në gjykatat kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, kandidatët për prokurorë dhe pozicione të tjera në Prokurorinë e Posaçme, kandidatët për drejtor, zëvendësdrejtor, hetues, oficer të shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe pozicione të tjera në Byronë Kombëtare të Hetimit firmosin deklaratën përkatëse me shkrim për heqjen dorë nga e drejta e tyre për pritshmëri për privatësi (jetë private) në telekomunikimet e tyre dhe në të dhënat financiare, të dhënë në shtojcat B1 e B2 të këtij ligji. Kjo deklaratë firmoset përpara se ata të caktohen me detyrë apo të punësohen. 2. Anëtarët e afërt të familjeve të personave të përmendur në pikën 1 gjithashtu firmosin deklaratën përkatëse për heqjen dorë nga të drejtat, të dhënë në shtojcën B3 të këtij ligji, si tregues se i kuptojnë kushtet...”.

14.2. Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar:

- Formularin “Vetëdeklarim (i gjyqtarëve dhe prokurorëve)”, Shtojca B, Deklarata 1, plotësuar dhe firmosur rregullisht nga kandidati, z. {...} i datës 16.04.2021.

14.3 Sa sipër, Këshilli vlerëson se kandidati, në respektim të përcaktimeve ligjore, ka dhënë pëlqimin e shprehur sipas formularit përkatës tip, për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”. Duke plotësuar kështu kriterin e “dhënies së pëlqimit (ai/ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

15. Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

15.1 “Mospasja masë disiplinore në fuqi” si kriter për ngritjen në detyrë edhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, që gjen reflektim në shkronjën “ç”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 127, datë 01.04.2021, është parashikuar në nenin 48, pika 8, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “*Vetëm kandidatët të cilët ... nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë*”.

15.2 Në rastin e kandidimit për ngritjen në detyrë edhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, kandidati ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 16.04.2021, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “*Nuk kam masë disiplinore në fuqi*”.

15.3 Më herët, në rastin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Vlorë, sipas informacionit të përcjell nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, ka rezultuar se kandidati z. {...} nuk kishte masa disiplinore në fuqi, ndërsa në pikën 28, të Vendimit nr. 15, datë 21.01.2021, Këshilli ka arritur në përfundimin se: “*Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se nuk vërtetohet që kandidati z. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi, duke plotësuar kështu kriterin e “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.*”.

15.4 Ndërkohë, mbas Vendimit të Këshillit nr. 15 datë 21.01.2021, nuk rezulton që ndaj kandidatit të jetë marrë ndonjë masë disiplinore¹.

15.5 Sa sipër, Këshilli vlerëson se nuk vërtetohet që kandidati z. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi duke plotësuar kështu kriterin e “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

16. Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.

¹ Referuar nenit 105 të Ligjit për Statusin vendosja e masës disiplinore ndaj gjyqtarit është kompetencë e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

16.1 Papajtueshmëria ambientale si kriter ndalues për ngritjen në detyrë edhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, që gjen reflektim në shkronjën “d”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 127, datë 01.04.2021, është parashikuar në nenin 8, pika 2, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Këshillat, gjatë ... ngritjes në detyrë të magjistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë jopropocionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, eficientia e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë”*. Ndërkohë, kuptimi i papajtueshmërisë ambientale përcaktohet në pikën 1, të kësaj dispozite ligjore, sipas të cilës: *“Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë”*. Sa i takon rasteve të papajtueshmërisë ambientale për sa lidhet me ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ato parashikohen në pikën 3, shkronja “a”, të kësaj dispozite ligjore, ku përcaktohet se: *“Papajtueshmëri ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni”*.

16.2 Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e kandidimit për ngritjen në detyrë edhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidati ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit *“Për situatën e papajtueshmërisë ambientale”* datë 16.04.2021, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.

16.3 Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidati në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ai kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

16.4 Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se për kandidatin z. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duke plotësuar kështu kriterin e *“papajtueshmërisë ambientale”*.

III. KONKLUZIONE

17. Referuar kërkesave të Vendimit 75/2019, duke mbajtur parasysh edhe përcaktimet e Vendimit nr. 127, datë 01.04.2021, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit paraprak të katër kritereve formale të kandidimit të z. {...}, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e

Organizuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

18. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit paraparak të katër kritereve formale të kandidimit për kandidatin z. {...}, konkretisht të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati i plotëson ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e tij nga kandidimi në lidhje me këto kritere. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të katër kritereve të sipërpërmendura të kandidimit dhe vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 127, datë 01.04.2021.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në pikën 4, të nenit 135, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në shkronjën “a” të pikës 2 dhe në pikën 3 të nenit 47, në pikën 7 të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, si dhe në pikën 9, të Vendimit të tij nr. 127, datë 01.04.2021, “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 127, datë 01.04.2021, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.
2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për

Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 127, datë 01.04.2021.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR